



**U zhvillua Konferenca e 36-të Vjetore e IOSCO-s**  
(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) prill 2011)

Organizata Ndërkombëtare e Komisionerëve të Letrave me Vlerë (IOSCO) mbylli Konferencën e 36-të Vjetore në Cape Town, në Afrikën e Jugut, gjatë periudhës 17-22 Prill, 2011.

Vijon në faqen 2

**Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura**

**Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-mars 2011**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar-mars 2011 arritën shifrën 2,232,657 mijë lekë, përkundrejt 2,071,568 mijë lekë të realizuara në janar-mars 2010 ose 7.78 % më shumë.

Vijon në faqen 3

**Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2011**

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2011 u dominua në masën 93.73% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 6.27% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Vijon në faqen 5

**Ngjarje dhe zhvillime të tjera**

**Zhvillohet takimi rajonal i rregullatorëve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore**

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA) në bashkëpunim me Autoritetin Hungarez të Mbikëqyrjes Financiare (HFSA), si iniciatorë të Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, zhvilluan në datat 12-13 prill në Vjenë, Austri, takimin rajonal me Mbikëqyrësit e Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Vijon në faqen 6

**Zhvillohet takimi mbi mbikëqyrjen e konsoliduar**

Banka Qendrore e Kroacisë në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Kroacisë, zhvilluan gjatë periudhës 12-14 prill, në Zagreb, takimin mbi mbikëqyrjen e konsoliduar. Në të morën pjesë rregullatorë të vendeve të Ballkanit.

Vijon në faqen 7

**Nëntë rregullatorë të letrave me vlerë i bashkohen MMoU-së të IOSCO-s**

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) prill 2011)

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) ka njoftuar, se nëntë rregullatorë të tjerë të letrave me vlerë, janë ftuar për t'u bërë nënshkruese me të drejta të plota të Memorandumit të Mirëkuptimit Shumëpalësh MMoU lidhur me Konsultimin,

Bashkëpunimin dhe Shkëmbimin e Informacionit.

Vijon në faqen 8

**Zhvillohet takimi i tretë i nënkomitetit BE - Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën**

Më 15 prill 2011, në Bruksel, u zhvillua takimi i tretë i nënkomitetit BE - Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën.

Vijon në faqen 8

**Zhvillohet seminari mbi principet bazë të sigurimit të përzgjedhur**

Instituti për Stabilitetin Financiar (FSI), zhvilloi në ambientet e Joint Vienna Institute gjatë periudhës 11-16 prill, në Vjenë, seminarin mbi principet bazë të sigurimit të përzgjedhur.

Vijon në faqen 9

**Zhvillohet trajnimi mbi zhvillimin e tregut të titujve**

Instituti Ndërkombëtar për Zhvillimin e Tregut të Titujve, zhvilloi gjatë periudhës 04-14 prill, në Washington DC, trajnimin 2-javor mbi zhvillimin e tregut të titujve.

Vijon në faqen 10

**Zhvillohet takimi mbi lançimin e projektit të përmirësimit të raportimit financiar të shoqërive**

Më 13 prill 2011, në ambientet e hotel "Rogner Europapark" u zhvillua takimi mbi lançimin e projektit të përmirësimit të raportimit financiar të shoqërive.

Vijon në faqen 10

**Edukimi i konsumatorit**

**Metodikë për identifikimin e institucioneve me peshë në sistemin financiar (Systemically Important Financial Institutions-SIFI) në fushën e sigurimeve**

(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e Shoqatës së Gjenevës "The Geneva Association", prill 2011)

**Pjesa I**

**Metodikë për identifikimin e institucioneve me peshë në sistemin financiar (Systemically Important Financial Institutions-SIFI) në fushën e sigurimeve**

**Përmbledhje Ekzekutive**

Në përgjigje të detyrës së vendosur nga grupi G-20 dhe Bordi i Stabilitetit Financiar (BSF) për të hartuar një metodikë për identifikimin e SIFI në fushën e sigurimeve, Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) duhet të hartojë një metodikë të përshtatshme me instrumentet e duhura për matjen e riskut të sistemit në mënyrë të posaçme në sektorin e sigurimeve.

Vijon në faqen 11

Në këtë numër:

Zhvillohet seminar mbi përdorimin e SNRF-ve për qëllime rregullatore dhe të kujdesshme **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **3**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **6**

Edukimi i konsumatorit **11**

## U zhvillua Konferenca e 36-të Vjetore e IOSCO-s

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) prill 2011)*

Organizata Ndërkombëtare e Komisionerëve të Letrave me Vlerë (IOSCO) mbylli Konferencën e 36-të Vjetore në Cape Town, në Afrikën e Jugut, gjatë periudhës 17-22 Prill, 2011.



Zj. Miranda Ramaj, Anëtare Bordi dhe Zj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike, pjesëmarrëse në këtë konferencë

Një numër i caktuar vendimesh u morr gjatë zhvillimit të Konferencës, ku ndër kryesoret, përmendim:

### - Drejtimi Strategjik i IOSCO-s

Komiteti Ekzekutiv për Drejtimin Strategjik paraqiti propozimet e tij lidhur me strukturën e re të komitetit dhe bazën financiare për miratim në Komitetin e Kryetarëve. Ky vendim siguron, se IOSCO, si vendosës i standardeve ndërkombëtare për rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë, është e strukturuar dhe e vendosur të vazhdojë të sigurojë udhëheqje në zhvillimin e standardeve rregullative për tregjet e kapitalit, ka burimet e nevojshme për t'u angazhuar në identifikimin e

risqeve të tregjeve të letrave me vlerë në zhvillim dhe posedon aftësinë për të përmbushur nevojat e anëtarëve të saj dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të shtruar nga G20 dhe Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB).

### - Objektivat dhe Parimet e IOSCO-s

Komiteti Ekzekutiv IOSCO-s, në fillim të krizës së fundit financiare botërore i kërkoi Task Force-s (ITF) rishikimin dhe freskimin e Parimeve të IOSCO-s për të marrë parasysh mësimet e nxjerra nga kriza. Në qershor 2010, kjo çoi në shtimin e tetë parimeve të reja adresuar çështjeve të tilla si risku sistematik në tregjet e letrave me vlerë, agjencitë e vlerësimit të kreditit, fondet e investimeve, mbikëqyrja dhe pavarësia e auditit, produktet në fushën e letrave me vlerë, si dhe përditësimin e metodologjisë që lidhet me to.

### - Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit i IOSCO-s, MMoU

Konferenca theksoi suksesin e IOSCO-s, arritur në takimin e vitit 2005, ku u vendos një objektiv ambicioz që të gjitha juridiksionet anëtare duhet të aplikojnë për t'u bërë nënshkruese të MMoU-së nga 1 janari 2010. Komitetet Rajonale të IOSCO-s, të ndihmuar nga Sekretariati i Përgjithshëm, kanë punuar së bashku me juridiksione në rajonet e tyre për të inkurajuar veprimet e nevojshme për t'u bashkuar me MMoU-në. IOSCO i ka kërkuar të gjithë anëtarëve e vëzhguesve të MMoU-së që me përgjegjësi të punojnë në juridiksionin e tyre, për të aplikuar për t'u bërë nënshkruese të MMoU-së deri më 1 janar 2013. Në kuadër të kësaj nisme, AMF u konfirmua si anëtare me të drejta të plota, nëpërmjet nënshkrimit të MMoU-së në qershor 2009, gjatë Konferencës së 34-vjetore të IOSCO-s, që u mbajt në Tel Aviv.

### - Nisma për të rritur Standardet e Bashkëpunimit Ndër-Kufitar

Nisma e Kontaktit të IOSCO-s për të nxitur juridiksionet në proces rregullimi të bëjnë

ndryshimet e nevojshme për anëtarësimin në MMoU-në vazhdon të jetë një prioritet i punës së saj. Një përparim i konsiderueshëm është bërë me një numër juridiksionesh, në të cilat kuadri ligjor nuk është tërësisht në përputhje me atë të kërkuar që këto juridiksione të bëjnë përmirësime reale e t'ju ofrojnë homologëve të tyre ndërkombëtarë informacione e duhura për të luftuar sjellje të palejuara ndërkufitare të tregut.

## - Komiteti Konsultativ i Organizatave Vetërregulluese i IOSCO-s – (SROCC)

Anëtarët e Komiteti Konsultativ të Organizatave Vetërregulluese të IOSCO-s (SROCC) shqyrtuan çështjet dhe zhvillime të tjera të kohëve të fundit të tregut, duke përfshirë ato që lidhen me ofertat e publikun. SROCC ra dakord të zgjerojnë më tej ndërveprimin me komisionet përkatëse të IOSCO-s dhe të vazhdojnë t'u japë ekspertizën anëtarëve të saj për vendosjen e standardeve, ngritjen e kapaciteteve dhe aktivitetëve në terren në kuadrin e drejtimeve të reja strategjike të IOSCO-s.


Në përfundim, Konferenca informoi mbi pranimin e anëtarëve të rinj në IOSCO dhe zgjedhjet e reja ne organet drejtuese të IOSCO-s. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate, u përfaqësua në këtë eveniment të rëndësishëm nga Zj. Miranda Ramaj, Anëtare Bordi dhe Zj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-mars 2011

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për janar-mars 2011 arritën shifrën 2,232,657 mijë lekë, përkundërt 2,071,568 mijë lekë të realizuara në janar-mars 2010 ose 7.78 % më shumë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 57.29% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 42.71% të tregut. Përsa i takon


rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 58.97% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje 3.22% të sigurimeve të Jo-Jetës. 87.96 % e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës dhe 12.04% u gjenerua nga veprimtaria e Jetës. Në janar-mars 2011 u nënshkruan rreth 296,893 kontrata sigurimi, ose rreth 119.79% më shumë se në janar-mars 2010.



## Volumi i primit të shkruar bruto, janar-mars (2010-2011)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
Janar-Mars	2010	2011
A) Sigurim i Jetës	169,135	268,875
B) Sigurim i Jo-Jetës	1,902,432	1,963,782
a) Sigurimi i Detyrueshëm	916,563	953,548
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	985,869	1,010,233
c) Risigurimi	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>2,071,568</b>	<b>2,232,657</b>

### Volumi i primit të shkruar bruto, janar-mars 2011 (Jeta dhe Jo-Jeta)



### Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-mars 2011, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 42.71% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-mars 2011, arritën 556,150 mijë lekë, ose 18.10% më pak se në janar-mars 2010.

Në janar-mars 2011, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 349,523 mijë lekë, ose rreth 90.10% më shumë se në janar-mars 2010.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-mars 2011 arritën në 47,875 mijë lekë, apo 10.73 % më pak se në janar-mars të 2010.

### Sigurimet vullnetare

Në janar-mars 2011, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,279,109 mijë lekë, ose 10.74% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Kritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,010,233 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 30.54%, të pasuara nga, sigurimi kasko me 14.04% dhe nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 12.70%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-mars 2011, arritën në 254,176 mijë lekë, 208.70% më shumë se në janar-mars 2010. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 90.69% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar-mars 2011 arritën në 268,875 mijë lekë, ose rreth 58.97% më shumë se në janar-mars 2010. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

## Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 37.35% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life



udhëhoqi tregun me 46.45% të primeve.

## Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-mars 2011 kapi vlerën 505,711 mijë lekë, ose 8.35% më shumë se në janar-mars 2010. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 358,391 mijë lekë, apo 70.87% të totalit.

## Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2011

Tregu sekondar i letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-mars 2011 u dominua në masën 93.73% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 6.27% nga instrumenta afatgjatë (obligacione). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.77% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2011, flasin për një dominim të transaksioneve “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” dhe “Blerje në tregun primar” përkatësisht me 45.54% dhe 28.95% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.40% të të gjitha transaksioneve në këtë treg, në raport me personat juridikë.


## Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-mars 2011 ka pasur një zbritje prej 1,764.51 milionë lekë ose në masën 50.02%, krahasuar me

periudhën janar-mars 2010, shoqëruar me një ulje në masën 38.16% të numrit të transaksioneve.

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”** gjatë periudhës janar-mars 2011 ka pasur një rritje prej 122.36 milionë lekë ose 17.67%, krahasuar me periudhën janar-mars 2010, ndjekur nga një rritje në masën 33.33% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me periudhën janar-mars 2010, vihet re një zbritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, të marra së bashku, me rreth 1,642.15 milionë lekë.



### Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë 2010, 2011

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
Janar-Mars		2010	2011	'11/10-1
<b>Letra me Vlerë të Qeverisë</b>				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	3,527.92	1,763.41	(50.02)
	Individë	2,329.37	1,405.18	(39.68)
	Persona juridike	1,198.55	358.23	(70.11)
C	Blerje nga individet para afatit të maturimit	692.25	814.61	17.67
	Individë	332.34	396.14	19.20
	Persona juridike	359.91	418.47	16.27

### Ngjarje dhe zhvillime të tjera

#### Zhvillohet takimi rajonal i rregullatorëve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA) në bashkëpunim me Autoritetin Hungarez të Mbikëqyrjes Financiare (HFSA), si iniciatorë të Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve, zhvilluan në datat 12-13 prill në Vjenë, Austri, takimin rajonal me Mbikëqyrësit e Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Ky takim ishte i pari në kuadër të iniciativës për

rritjen e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes mbikëqyrësve të CESEE [Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore] duke u fokusuar në tema që lidhen, në mënyrë të veçantë, me rajonin. Iniciativa gjeti përkrahje nga shumica e vendeve të CESEE, duke përzgjedhur si tema aktuale për diskutim, si më poshtë:

- Solvency II – Implementimi i kolonës së dytë
- Kolegjet Mbikëqyrëse
- Mbrojtja e konsumatorit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve
- Sigurimi i detyrueshëm motorik

Objektivat kryesore të kësaj iniciative janë:

- promovimi dhe mbajtja e marrëdhënie të ngushta të bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes mbikëqyrësve të sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore;
- ngritja e forumeve për diskutime mbi tregun e sigurimeve dhe problemeve të mbikëqyrjes;
- mundësitë për shkëmbime të teknikave të mbikëqyrjes, përvojave, informacioneve dhe ekspertizës;
- ndihma në zbatimin e ligjeve dhe direktivave, si dhe;
- shkëmbimi i pikëpamjeve dhe përvojave në lidhje me zbatimin e Solvency II.

AMF, në këtë takim të nivelit të lartë, u përfaqësua nga Kryetarja, Zj. Elisabeta Gjoni, e cila moderoi panelin e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik. Takimi rezultoi i suksesshëm, me diskutime dhe shkëmbime eksperiencash të vlefshme midis rregullatorëve të pranishëm, duke i hapur rrugën një bashkëpunimi efektiv në të ardhmen e duke krijuar kështu një forum, ku rregullatorët e CESEE mund të diskutojnë mbi çështjet dhe problematikat e përbashkëta që hasen në rregullimin e tregut të sigurimeve në këto vende.

### **Zhvillohet takimi mbi mbikëqyrjen e konsoliduar**

Banka Qendrore e Kroacisë në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare të Kroacisë, zhvilluan gjatë periudhës 12-14 prill, në Zagreb, takimin mbi mbikëqyrjen e konsoliduar. Në të morën pjesë rregullatorë të vendeve të Ballkanit.

Objekti kryesor i prezantimeve kishte të bënte me organizimin e mbikëqyrjes së konsoliduar, bazuar në strukturën e komplikuar që kanë institucionet financiare sot. Prezantimet paraqisnin përvojën kroate në këtë aspekt, sidomos përmbajtjen e akteve të tyre ligjore e rregullative, të hartuara në përputhje me direktivat e BE-së, si pjesë e procesit të anëtarësimit të Kroacisë në BE.

Përvoja e prezantuar u përqendrua në këto aspekte kryesore: (i) Mbikëqyrja e konsoliduar dhe (ii) Bashkëpunimi i mbikëqyrësve.

*(I) Mbikëqyrja e konsoliduar, e nevojshme për t'u kryer me rritjen e shkallës së transaksioneve financiare që tejkalojnë kufijtë e një vendi dhe rritjen e shkallës së komplikimit të strukturave të institucioneve financiare.*

Në këtë temë prezantimet trajtuan:

- mbikëqyrjen mbi bazë rreziku dhe dallimin nga metoda tradicionale e mbikëqyrjes;
- përbërjen e grupeve bankare dhe mbikëqyrjen e tyre mbi bazë të konsoliduar;
- kërkesat rregullatore për një mbikëqyrje të konsoliduar;
- çështje kontabël dhe të raportimit në lidhje me mbikëqyrjen e konsoliduar, si dhe;
- konglomeratet financiare dhe mbikëqyrja e tyre

*(ii) Bashkëpunimi i mbikëqyrësve brenda autoriteteve të një vendi dhe midis autoriteteve të vendeve të ndryshme si një masë e domosdoshme për të realizuar mbikëqyrje të konsoliduar efektive.*

Në këtë temë prezantimet trajtuan:

- funksionimin e kolegjeve të mbikëqyrësve;
- marrëveshjet e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacioneve me autoritetet mbikëqyrëse brenda dhe jashtë vendit;
- marrëveshjet e menaxhimit të krizës financiare, si dhe;
- koordinimin në nivel evropian të veprimtarisë mbikëqyrëse dhe rolin e EBA-së (European Banking Authority) dhe të Bordit të Riskut.

Kuadri ligjor dhe rregullativ i Kroacisë është vlerësuar në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Në këtë pikëpamje, përvoja kroate në hartimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ është e dobishme për vende që janë në proces integrimi me BE-në dhe që do të duhet të harmonizojnë legjislacionet përkatëse. Nga ana tjetër, përvoja kroate nuk ofronte dot diçka më konkrete apo më praktike në lidhje me zbatueshmërinë e këtij kuadri ligjor dhe rregullativ, për arsye të nivelit

të zhvillimit të tregut financiar dhe faktit që një pjesë e fenomeneve të parashikuara në legjislacion apo marrëveshje ende nuk ishin zhvilluar apo shfaqur në vend.

Gjithsesi, rritja e shkallës së bashkëpunimit me autoritete të tjera mbikëqyrëse nga vendet e BE-së dhe prania në kolegje mbikëqyrësish ka nxjerrë një mësim të vlefshëm, atë të përpjekjeve dhe investimeve të konsiderueshme që duhen bërë për të trajnuar dhe specializuar punonjësit e autoriteteve rregullatore.

### **Nëntë rregullatorë të letrave me vlerë i bashkohën MMoU-së të IOSCO-s**

*(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) prill 2011)*

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) ka njoftuar, se nëntë rregullatorë të tjerë të letrave me vlerë, janë ftuar për t'u bërë nënshkruese me të drejta të plota të Memorandumit të Mirëkuptimit Shumëpalësh MMoU lidhur me Konsultimin, Bashkëpunimin dhe Shkëmbimin e Informacionit.

Nënshkruesit e rinj janë:

- 1- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Estonisë
- 2- Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit të Japonisë
- 3- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë së Japonisë
- 4- Komisioni i Letrave me Vlerë të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë
- 5- Komisioni i Letrave me Vlerë të Pakistanit
- 6- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Suedisë
- 7- Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Taivanit Kinez
- 8- Autoriteti i Tregjeve të Kapitalit dhe Letrave me Vlerë të Tanzanisë
- 9- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Liechtestein

Me miratimin e Liechtestein për anëtarësim, numri i juridiksioneve, të cilët janë pranuar si

nënshkrues të MMoU-së së IOSCO-s tani është në 80. Në vazhdim, 36 juridiksione të tjera janë në proces të verifikimit të plotë dhe tani pritet të punojnë për të hequr pengesat për të kaluar në statusin e nënshkruesve të plotë.

Këto nënshkrues të plotë të MMoU-së tani mund të kërkojnë dhe të ndajnë informacione konfidenciale në ndjekjen e veprave ndërkufitare të letrave me vlerë.

### **Zhvillohet takimi i tretë i nënkomitetit BE - Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën**

Më 15 prill 2011, në Bruksel, u zhvillua takimi i tretë i nënkomitetit BE - Shqipëri për tregun e brendshëm dhe konkurrencën.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i zhvillimeve legjislative dhe institucionale të Shqipërisë në fushat e tregut të brendshëm dhe konkurrencës dhe vlerësimi nga pala evropiane e progresit të bërë nga Shqipëria në përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga dokumentet strategjike si: MSA, Partneriteti Evropian, Raporti Analitik KE 2009-2010, angazhimet e ndërmarra në planin kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2010-2014.

*Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në këtë takim, paraqiti një raport mbi fushat të cilat rregullohen dhe mbikëqyren nga ky institucion: sigurimet, letrat me vlerë dhe pensionet vullnetare, duke u fokusuar në aspektin e zhvillimeve legjislative, ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale gjatë vitit 2010.*

Në prezantimin e tij, AMF paraqiti zhvillimet legjislative, sikurse ishin draftimi i ligjit të ri të fushës së sigurimeve, hartimi i akteve nënligjore në fushën e pensioneve vullnetare dhe të letrave me vlerë. Në lidhje me fuqizimin e rolit mbikëqyrës u vunë në dukje projektet e realizuara tashmë nga AMF, si hartimi i metodologjisë më fokus riskun në kuadrin e





projektit FIRST të Bankës Botërore dhe instalimi i platformës së re të raportimit elektronik të mbikëqyrjes AMF In-Reg me qëllim informatizimin e procesit të raportimit të shoqërive të sigurimit dhe fondeve të pensionit në AMF, projekt i përbashkët i AMF-së me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Gjatë takimit u prezantuan edhe çështje që kishin të bënin me forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale si faktorë të rëndësishëm të procesit të integritetit të vendit dhe angazhimeve të institucionit në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Në përfundim të prezantimit, anëtarët e komisionit drejtuan një sërë pyetjesh të cilat kryesisht u fokusuan në: përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të fushës së pensioneve vullnetare dhe letrave me vlerë me acquis, krijimin e institucionit të ombudsmen-it financiar, rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të AMF dhe perspektivën e zbatimit të Solvency II.

### **Zhvillohet seminari mbi principet bazë të sigurimit të përzgjedhur**

Instituti për Stabilitetin Financiar (FSI), zhvilloi në ambientet e Joint Vienna Institute gjatë periudhës 11-16 prill, në Vjenë, seminarin mbi principet bazë të sigurimit të përzgjedhur.

Seminari u fokusua në prezantimin, trajtimin dhe diskutimin e disa prej principeve bazë të sigurimit dhe në rëndësinë e zbatimit të tyre prej autoriteteve mbikëqyrëse.

Temat kryesore të trajtuara gjatë seminarit ishin mbi: licencimin e shoqërive të sigurimit; ndërmjetësit e sigurimeve, licencimi dhe mbikëqyrja e tyre; mbikëqyrja e vazhdueshme dhe vlerësimi i riskut; mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit si pjesë e një grupi financiar dhe ndërhyrja.

**Parimet kryesore të sigurimeve (ICPs) në mbikëqyrjen efektive** - Ky prezantim kishte për objekt prezantimin e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve duke dhënë një informacion mbi objektivat dhe aktivitetet kryesore të saj nga publikimi i principeve, standardeve dhe udhëzimeve e deri tek kërkimet praktike mbi identifikimin e risqeve që mund të influencojnë në tregun e sigurimeve.

**Infrastruktura dhe sistemi mbikëqyrës** - Tema trajtoi infrastrukturën e sistemit mbikëqyrës, objektivat e autoriteteve mbikëqyrëse, etj., në një vizion më të gjerë, duke përfshirë dhe kuadrin rregullator, sistemin e drejtësisë, tregjet financiare zhvillimin dhe funksionimin e tyre, nevojën për staf të kualifikuar, disponueshmërinë e informacioneve ekonomike dhe statistikore si për përdorim të tyre nga mbikëqyrësit ashtu edhe nga tregu.

**Ndërmjetësit e sigurimeve dhe sjellja e tyre në treg** - Tema trajtoi çështjet lidhur me ndërmjetësit në sigurimeve, duke trajtuar kryesisht kriteret për licencimin e tyre, nevojën e mbikëqyrjes së vazhdueshme nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe mënyrat e sjelljes së tyre në treg si përfaqësues të kompanisë (agjent) dhe të klientëve (broker).

**Aftësia paguese** - Tema trajtoi standardet ndërkombëtare rreth aftësisë paguese të shoqërive të sigurimit në një mbikëqyrje me bazë risku, kërkesat mbi kapitalin në lidhje me aftësinë paguese, kapitalin minimal të kërkuar dhe kapitalin e sugjeruar, si dhe me masat e ndryshme që mund të merren në nivle të ndryshme.

**Menaxhimi i rrezikut** - Tema prezantoi një përmbledhje mbi strukturën e menaxhimit të rrezikut, politikat e menaxhimit të riskut duke trajtuar mënyrat e identifikimit dhe të matjes së rrezikut, politikat e investimit dhe kontratat e nënshkruara.

### **Mbikëqyrja e vazhdueshme dhe vlerësimi i**

**rrezikut** - Tema trajtoi parimet kryesore, historikun, karakteristikat dhe dobitë e mbikëqyrjes.

**Struktura e shoqërive të sigurimi dhe rregullimi i tregut** - Tema trajtoi standardet ndërkombëtare, praktikat më të mira dhe rëndësinë e mbikëqyrjes.

**Mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit** - Tema trajtoi mësimet që dolën nga kriza globale, qëllimin e mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit, rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar për ushtrimin e mbikëqyrjes, etj.

Rastet e studimit, të trajtuara në fund të seminarit, i dhanë mundësi përfaqësuesve të vendeve pjesëmarrëse, të ndajnë eksperiencat e tyre dhe të diskutojnë për temat e prezantuara.

Në përfundim, u ndanë certifikata për gjithë pjesëmarrësit.

### **Zhvillohet trajnimi mbi zhvillimin e tregut të titujve**

Instituti Ndërkombëtar për Zhvillimin e Tregut të Titujve, zhvilloi gjatë periudhës 04-14 prill, në Washington DC, trajnimin 2-javor mbi zhvillimin e tregut të titujve.

Programi ishte projektuar si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira për zhvillimin dhe rregullimin e tregut të letrave me vlerë, të prezantuara këto nëpërmjet leksioneve, tavolinave të rrumbullakta dhe studimit të rasteve të ndryshme.

Gjatë javës së parë të programit u diskutuan tema të ndryshme si: sfidat për rregullatorët e letrave me vlerë, menaxhimi i krizave për rregullatorët e letrave me vlerë, hetimi dhe ndjekja e tregtimit të brendshëm, hetimi dhe ndjekja e manipulimit të tregut, procedurat dhe teknikat e hetimit, inteligjenca e tregut, si dhe

sistemet dhe teknikave e mbikëqyrjes, zbatimi i ligjeve të letrave me vlerë dhe procedimet paralele, masat dhe sanksionet e përshtatshme për shkeljen e ligjeve të letrave me vlerë. Gjithashtu gjatë kësaj jave u bë studimi në grup i rasteve, të cilat kanë lidhje manipulimi me tregun.

Ndërsa java e dytë u fokusua në çështje si: vështrim i përgjithshëm i menaxhimit të investimeve, edukimi i investitorit, përballimi me njohjen e ndërsjellë të standardeve të deklaramit, brokerat dhe standardet e mbikëqyrjes, çështjet në strukturën e tregut, qeverisja e korporatave, kontabiliteti dhe auditimi, agjencitë e klasifikimit të kredive, si dhe si të zhvillosh tregun e letrave me vlerë. Studimi në grup i kësaj jave ju kushtua brokerit.

Në këtë program trajnimi ndanë eksperiencat e tyre ekspertë të ndryshëm, përfaqësues të agjencive qeveritare, si dhe përfaqësues nga industria dhe aktorë të ndryshëm të tregut të letrave me vlerë në Shtetet e Bashkuara.

Ky program ju dha mundësi përfaqësuesve të vendeve me tregje në zhvillim të ndajnë eksperiencat e tyre dhe të diskutojnë për parimet bazë të tregut të titujve, fokusuar në zgjidhjen e krizave dhe abuzimeve të tregut, duke theksuar gjithashtu praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në këtë program morën pjesë përfaqësues nga 61 vende të ndryshme të botës e në përfundim të tij u shpërndanë certifikata të pjesëmarrjes për të gjithë të pranishmit.

### **Zhvillohet takimi mbi lançimin e projektit të përmirësimit të raportimit financiar të shoqërive**

Më 13 prill 2011, në ambientet e hotel “Rogner Europapark” u zhvillua takimi mbi lançimin e projektit të përmirësimit të raportimit financiar të shoqërive, i cili do të zbatohet nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Financave me

mbështetjen e programit REPARIS (Rruga për në Evropë: Programi për Kontabilitetin dhe Fuqizimin Institucional) të Bankës Botërore.

Projekti ka për qëllim krijimin e një ambienti transparent politikash dhe kornizash efektive institucionale për raportimin financiar të shoqërive, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Z. Andrei Busuoiç, përfaqësues i Bankës Botërore (për projektin REPARIS) prezantoi qëllimet dhe komponentët e projektit. Projekti në fjalë pritet të zbatohet në një periudhë 8-10 vjet, e cila do të jetë e shtrirë në tri faza. Banka Botërore ka ofruar mbështetje për zbatimin e fazës së parë.

Përgjegjësia e përgjithshme për zbatimin e projektit i takon MF, ndërsa KKK (Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit) do të luajë rol mbikëqyrës. Grupet e interesit që do të jenë të përfshira direkt në projekt do të jenë: Ministria e Financave, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, IEKA (Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar), universitetet dhe shoqata të kontabilistëve. Faza e parë e projektit parashikohet të zbatohet deri në fund të vitit 2013.

Komponentët e projektit janë pesë:

1. përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e raportimit financiar (grupet e interesit: MF, KKK, Komisioni Ekonomik Parlamentar);
2. fuqizimi i kapaciteteve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (grupet e interesit: MF, KKK);
3. ngritja e një sistemi të kontrollit mbikëqyrës të auditimit (grupet e interesit: BPM, IEKA);
4. përmirësimi i programeve mësimore të kontabilitetit dhe auditimit për arsimimin universitar dhe certifikimin profesional (grupet e interesit: shoqatat profesionale dhe universitetet në fushën e arsimit kontabël);
5. menaxhimi i projektit, fuqizimi i kapacitetit të reformës së monitorimit - vlerësimit (grupet e interesit: MF dhe CFCU - Njësia e menaxhimit të projektit pranë MF).

Z. Busuoiç prezantoi gjithashtu dhe çështje të administrimit dhe zbatimit të projektit, duke u fokusuar në proceset kryesore të projektit dhe palët përgjegjëse për realizimin e tyre. Proceset kryesore konsistojnë në: bashkërendimin e përgjithshëm, planifikimin dhe buxhetin, termat e referencës, prokurimin, menaxhimin e zbatimit të kontratave, drejtimin financiar, monitorim-vlerësimin, mbështetjen për zbatimin dhe mbikëqyrjen e reformës e projektit.

Gjatë takimit u trajtuan disa çështje kryesore në lidhje me praktikën e Bankës Botërore në lidhje me prokurimin dhe menaxhimin e projektit. U përmendën procedurat dhe udhëzimet e zbatueshme në prokurim, dokumente të rëndësishme të këtyre proceseve, plani i prokurimit, si dhe masat për shqyrtim.

Në kuadër të aktivitetit të AMF-së, ky projekt krijon përfitime indirekte të përqendruara kryesisht në dy drejtime:

- Së pari, projekti synon të arrijë përmirësime në cilësinë e profesionistëve (kontabilistëve dhe ekspertëve kontabël të regjistruar përmes trajnimeve dhe mbështetjes për organizatat profesionale), gjë që mund të ndikojë në raportimet Financiare të shoqërive të sigurimit.
- Së dyti, projekti ka si qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, gjë që do të çojë në një punë më efektive të këtij bordi dhe në rritjen e cilësisë së auditimeve të kryera nga ekspertët kontabël të regjistruar.

## Edukimi i konsumatorit

### Metodikë për identifikimin e institucioneve me peshë në sistemin financiar (Systemically Important Financial Institutions-SIFI) në fushën e sigurimeve

Kontribut për diskutimet e Bordit të Stabilitetit Financiar dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve

(Material i përpunuar, nxjerrë nga faqja zyrtare e Shoqatës së Gjenevës "The Geneva Association", prill 2011)

## Pjesa I

### **Metodikë për identifikimin e institucioneve me peshë në sistemin financiar (Systemically Important Financial Institutions-SIFI) në fushën e sigurimeve**

#### **Përmbledhje Ekzekutive**

Në përgjigje të detyrës së vendosur nga grupimi G-20 dhe Bordi i Stabilitetit Financiar (BSF) për të hartuar një metodikë për identifikimin e SIFI, Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) duhet të hartojë një metodikë të përshtatshme me instrumentet e duhura për matjen e riskut të sistemit në mënyrë të posaçme në sektorin e sigurimeve.

Shoqata e Gjenevës, së bashku me organizatat e tjera të sigurimeve, rekomandon një qasje sipas aktiviteteve, të zhvilluar me dy hapa: Së pari, identifikimi i aktiviteteve të cilat mund të mbartin risk për sistemin financiar dhe së dyti, përdorimi i treguesve specifik të përshtatur sipas këtyr aktiviteteve për të identifikuar SIFIt.

Raporti i nxjerrë nga Shoqata e Gjenevës, me titull “Risku sistematik në fushën e sigurimeve: analizë e sigurimeve dhe stabilitetit financiar”,<sup>1</sup> i cili është mbështetur gjerësisht, konstatonte se aktivitetet bazë të sigurimeve nuk përbëjnë rrezik ndaj stabilitetit të sistemit financiar dhe ekonomik. Mirëpo, ka dy aktivitete që mund të mbartin risk për sistemin në të cilat mund të përfshihen siguruesit, dhe të cilat kërkojnë vlerësim të mëtejshëm nëse kryhen në shkallë të madhe dhe nën një mbikëqyrje të pamjaftueshme të riskut: spekulimi me instrumentet derivative/dorëzanitë financiare dhe keqadministrimi i financimit afatshkurtër. Në përgjigje të konsultimeve të IAIS, Shoqata e Gjenevës përcaktoi një paketë treguesish për identifikimin e institucioneve financiare të rëndësishme për sistemin që realizojnë një ose të dy këto aktivitete që mund të mbartin risk për sistemin.

Për të pasur një vëzhgim efikas të sistemit, të procesit të identifikimit të riskut sistematik, kërkohet një sistem i përshtatshëm mbikëqyrës. IAIS duhet të udhëheqë bashkërendimin e vëzhgimit makro në fushën e sigurimeve, ku mbikëqyrësit kombëtarë të sigurimeve të asistojnë për mbikëqyrjen mikro.

Zbatimi i një metode me të meta ka disa pasoja negative:

- rrezikon mosidentifikimin e shoqërive që kryejnë aktivitete me risk për sistemin,
- rrezikon përfshirjen e shoqërive që nuk kryejnë aktivitete me risk për sistemin,
- shpërdoron burimet e organit rregullator,
- mund të bartë pasoja negative jo vetëm për siguruesin por edhe për të gjithë sektorin e sigurimeve, policëmbajtësit dhe ekonominë në përgjithësi.

Shoqata e Gjenevës ka një interes të madh për të kontribuar në punën e IAIS-it në lidhje me rikun sistematik dhe stabilitetin financiar dhe është e gatshme të mbështesë përpjekjet globale për krijimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në tregjet globale.

#### **1. Hyrje**

Rekomandimet e BSF<sup>2</sup> i kanë përkufizuar institucionet me peshë në sistemin financiar si “institucione financiare dështimi i çrregullt i të cilave, për shkak të madhësisë, kompleksitetit dhe lidhjes së ngushtë që kanë me sistemin, do të shkaktonte një çrregullim të ndjeshëm në sistemin financiar dhe veprimtarinë ekonomike”. Në bazë të kësaj, BSF ka filluar procesin e përcaktimit të metodikës për identifikimin e institucioneve financiare që mund të jenë të

<sup>1</sup> “Risku sistematik në fushën e sigurimeve: analizë e sigurimeve dhe stabilitetit financiar”, raport i posaçëm nga Grupi i Punës për Riskun e Sistemit, Shoqata e Gjenevës, Gjenevë, mars 2010.

<sup>2</sup> Për shembull, shih raportin e BSF-së “Ulja e rrezikut moral që vjen nga institucionet financiare me rëndësi për sistemin” ([http://www.financialstabilityboard.org/publications/r\\_101111a.pdf](http://www.financialstabilityboard.org/publications/r_101111a.pdf)).

rëndësishme për sistemin dhe i ka ngarkuar IAIS-it detyrën për ta mbështetur këtë punë në mënyrë specifike në sektorin e sigurimeve.<sup>3</sup> Prej atëherë, IAIS ka çelur konsultimet brenda sektorit, duke propozuar një metodikë të mundshme dhe një paketë treguesish për vlerësimin e rëndësisë së sigurveve për sistemin.

Është e rëndësishme të vlerësohet çdo sektor i industrisë sipas karakteristikave dhe rrethanave shumë të veçanta të secilit. Modelet e biznesit të sigurveve dallojnë dukshëm nga modelet e biznesit të bankave. Për rrjedhojë, sigurveit duhet të trajtohen më vete brenda diskutimit të riskut sistematik dhe për ta duhen zbatuar metoda dhe tregues të ndryshëm. Qëllimi i këtij studimi është rekomandimi i një qasjeje të përshtatur për këtë sektor, në lidhje me analizën e aktiviteteve që mund të mbartin risk për sistemin dhe identifikimin e institucioneve financiare që mund të jenë të rëndësishme për sistemin në sektorin e sigurimeve.

Sipas Shoqatës së Gjenevës, për të mundësuar një kornizë të përshtatshme dhe shpërndarje efektive të burimeve të organeve rregullatore dhe mbikëqyrëse, çdo qasje e propozuar duhet të jetë sa më e fokusuar te burimet e mundshme të risqeve të sistemit dhe jo te mbulimi i të gjithë institucioneve financiare pa dallim mes tyre. Për pasojë, një kornizë e efektshme do të kërkonte në fillim të identifikonte aktivitetet që mund të mbartin risk dhe pastaj të identifikonte institucionet që i kryejnë këto aktivitete.

Në mënyrë të pavarur, FED ka propozuar të njëjtën qasje gjatë diskutimeve për rastin “Lehman”, Patrick Parkinson, Zëvendësdyrëtor i Degës së Kërkimit dhe Statistikave pranë Bordit të Rezervës Federale, përshkruante një plan loje për mënyrën e vlerësimit të nevojës për ta shpëtuar institucionin “Lehman Brothers” në muajin gusht 2008, me:

- (1) identifikimin e aktiviteteve të këtij institucioni që mund t'i dëmtonin ndjeshëm institucionet

- financiare dhe ekonominë, nëse ai do të bënte kërkesë për mbrojtje nga falimentimi;
- (2) mbledhjen e informacionit për të vlerësuar me më shumë saktësi pasojat e mundshme të dështimit të tij dhe;
- (3) identifikimin e masave për zbutjen e riskut në fushat ku dëmi mund të jetë serioz.<sup>4</sup>

Shoqata e Gjenevës ka qenë një kontribues i madh në diskutimet për riskun e sistemit në fushën e sigurimeve me dy raporte të nxjerra enkas (“Risku i sistemit në fushën e sigurimeve: analizë e sigurimeve dhe stabilitetit financiar” dhe “Stabiliteti financiar kyç në fushën e sigurimeve”), disa artikuj dhe studime dhe shumë prezantime përpara grupeve të ndryshme të interesit brenda dhe jashtë sektorit të sigurimeve.<sup>5</sup> Ajo ka një interes të madh të vazhduar në dhënien e kontributit për punën rregullatore lidhur me riskun e sistemit dhe stabilitetin financiar.

## **2. Modelet e biznesit të sigurveve dhe bankave nuk janë të njëjta**

Deri tani, bashkësia e mbikëqyrësve e ka përqendruar punën e saj për identifikimin e institucioneve financiare me rëndësi për sistemin kryesisht te bankat, duke qenë se këto të fundit janë ndër më shumë gjatë krizës. Po kështu, më parë është punuar shumë për të kuptuar riskun sistematik në sektorin bankar, çka është motivuar kryesisht nga roli qendror që ka pasur ky sektor në krizat e mëdha të sistemit financiar në të kaluarën. Mirëpo, duke qenë se aktivitetet e sigurimeve nuk kanë qenë asnjëherë në themelin e një krize financiare globale, ka shumë pak analiza të riskut të sistemit dhe sigurimeve. Duke qenë se sigurveit dhe bankat kanë role të ndryshme në ekonomi, me modele biznesi të

<sup>3</sup> Në këtë dokument, termi “sigurime” përdoret në përgjithësi për të përshkruar sigurimin dhe risigurimin, nëse nuk thuhet ndryshe.

<sup>4</sup> Sipas Raportit Hetimor për Krizën Financiare (Komisioni Kombëtar për Shkaqet e Krizës Financiare dhe Ekonomike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 2011).

<sup>5</sup> Këto materiale mund të shikohen në [www.genevaassociation.org](http://www.genevaassociation.org)

ndryshme, siguruesit duhen trajtuar sipas modelit të tyre të biznesit.

Funksionet kryesore të siguruesve janë dhënia e mbrojtjes përmes pranimit të risqeve nga policëmbajtësit, duke i përqëndruar këto risqe e duke i administruar ato në mënyrë aktive. Për shkak të rolit të tyre dhe periudhës afatgjatë të shumë kontratave të sigurimeve, siguruesit administrojnë shuma të mëdha investimesh për të mundësuar pagimin e dëmeve në të ardhmen. Pra, për rrjedhojë, ata janë aktorë të rëndësishëm mes institucioneve të tjera financiare, lidhur me administrimin e aktiveve dhe akumulimin e kapitalit.

Modeli i biznesit i sigurimeve (i cili përfshin siguruesit dhe risiguruesit) ka karakteristika të veçanta, të cilat dallojnë nga bankat dhe e bëjnë këtë model burim stabiliteti në sistemin financiar.

Së pari, sigurimet financohen nga prime që paguhen paraprakisht, çka u jep siguruesve flukse të qënësishme monetare pa pasur nevojë për të kërkuar fonde pranë institucioneve të tjera. Policat e sigurimeve në përgjithësi janë afatgjata, ku flukset monetare dalëse janë të kontrollueshme, çka u jep mundësi siguruesve të veprojnë si stabilizatorë për sistemin financiar. Kështu, aktivitetet e sigurimit kanë një “cikël i përmbysur prodhimi” dhe financojnë vetveten përmes flukseve hyrëse nga primet, me burime afatgjata kapitali, çka sjell një cikël pozitiv likuiditeti. Siguruesit synojnë ta përputhin kohëzgjatjen e aktiveve dhe pasiveve dhe, rrjedhimisht, mbajnë aktive më afatgjata kundrejt pasiveve më afatgjata dhe nuk e rrisin bazën e aktiveve të tyre përmes marrjes së pasiveve afatshkurtra, ndërsa bankat merren me shndërrimin e periudhës së maturimit të pasiveve likuide afatshkurtra në aktive më afatgjata.

Bankat pranojnë depozita nga klientët dhe institucionet e tjera financiare dhe emetojnë letra

me vlerë të borxhit për të financuar aktivitetin tregtar të tyre. Këto para përdoren për t'u dhënë fonde afatgjata bizneseve dhe familjeve. Ky është një funksion i rëndësishëm për ekonominë, i cili realizon përfitime me peshë, por në vetvete mbart risk dhe zakonisht çon në një cikël likuiditeti negativ dhe risk të mundshëm likuiditeti.

Së dyti, risqet e shoqërive të sigurimit dhe bankave ndryshojnë në themel. Risku i sigurimit është i veçantë dhe, në pjesën më të madhe, është i pavarur nga cikli ekonomik. Për më tepër, normalisht siguruesit e mëdhenj arrijnë një diversifikim të mirë, si gjeografikisht ashtu edhe sa i takon shpërndarjes në pista të ndryshme biznesi. Ndërsa risqet e bankave kanë në përgjithësi një korrelacion më të lartë me ciklin ekonomik. Kur pranojnë depozita dhe japin kredi, bankat marrin përsipër dy risqe të mëdha, të cilat nuk diversifikohen mirë në kohëra krizash: riskun e kredisë, që lidhet me aktivitetet huadhënëse, dhe riskun e likuiditetit për shkak të mospërputhjes që lind nga huamarrja afatshkurtër dhe huadhënia afatgjatë. Së treti, administrimi i aktiveve dhe pasiveve është një aktivitet qendror për shoqëritë e sigurimeve. Siguruesit mbajnë aktive të shumta të cilat i përputhin me pasivet e tyre. Funksionet investuese të siguruesve dallojnë, për rrjedhojë, nga administratorët e pasurive të të tretëve (për shembull, bankat) të cilët administrojnë kundrejt një treguesi krahasues tregu (që mund të jetë një indeks aktivesh ose një indeks monetar). Bilancet tejet të rregullta të siguruesve ndihmojnë në kufizimin e pjesës së aktiveve që janë të zbuluara ndaj riskut. Bazat e aktiveve të siguruesve përbëhen kryesisht nga letra me vlerë shumë të tregtueshme.

Dhe së fundi, edhe në rast falimentimi të një institucioni të madh sigurimesh, efekti në ekonomi në përgjithësi ndryshon mjaft nga ai i një banke. Nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis siguruesit dhe sistemit të pagesave, në të cilin siguruesit janë përdorues por jo

organizatorë. Likuidimi i një siguruesi shtrihet gjatë një periudhe më të gjatë, e cila shpesh zgjat disa vjet, dhe ka shumë të ngjarë të jetë një proces i rregullt, i cili përshkruhet shkurtimisht më poshtë:

- Dëmet shlyhen në rrjedhën normale të aktivitetit tregtar. Duke qenë se siguruesve u kërkohet të mbajnë rezerva kundrejt dëmeve të lindura, të cilat mund të raportohen ose jo nga mbajtësit e policave, evitohet procesi i përshpejtuar i likuidimit.
- Ndërhyrja e hershme e mbikëqyrësve u jep mundësi administratorëve të siguruesit të punojnë me entin rregullator përkatës për të ndikuar në kalimin e aktivitetit tregtar të pjesëmarrësve të tjerë të tregut, në interesin më të mirë të mbajtësve të policave.
- Edhe për zhvillimin e dëmeve pas skadimit të policës, siç e tregojnë informacionet historike,<sup>6</sup> ka shkallë të ulëta kthimit të policave të jetës dhe pasivet vazhdojnë të shlyhen sipas ritmit fillestar. Duke qenë se kthimi i policave zakonisht lidhet me penalitete të rënda për policëmbajtësin, pesha e kthimeve në portofolin e jetës të pasiveve gjatë likuidimit të siguruesit ndikohen shumë më pak nga ndryshimi i preferencave të klientëve dhe nuk mund të krahasohen me rastin e bankave. Pra, nuk ka një rritje të menjëhershme të nevojës për likuiditet. Duhet theksuar gjithashtu se zhvillimi i dëmeve pas skadimit të policës në portofolet e mbyllura të jetës mund të jetë një aktivitet i pëlqyeshëm tregtar për disa sigurues, siç e tregon tregtimi i vazhdueshëm i portofolave të tillë.
- Falimentimi i një shoqërie sigurimi zgjat shumë vjet, shpesh duke filluar shumë kohë përpara çeljes së procedurës së likuidimit, duke qenë se pasivet maturohen gjatë një periudhe të gjatë kohore. Maturimi i gjatë i pasiveve mundëson rifitimin e vlerave të tregut të aktiveve të lidhura (shih më poshtë për përkufizimin) të cilat nuk mund të përdoren nga kreditorët e tjerë përveç policëmbajtësit dhe vetëm në rretha të paracaktuara.
- Nga këndvështrimi i sistemit, është e

rëndësishme të vërehet struktura e veçantë e portofolit të siguruesve. Siguruesit nuk kanë portofolë me tregtim me dy kahe, sepse kryesisht ata kanë vetëm një grup policëmbajtësish dhe vetëm një grup aktivesh (investimet). Po kështu, spiralet e riskut të netimit, kolateralit dhe kundërpartisë nuk përbëjnë risqe të rëndësishme në rast likuidimi të një siguruesi.

- Siguruesit, kur kanë vijueshmëri të biznesit, krijojnë flukse monetare pozitive nga veprimtaritë e shfrytëzimit dhe, kështu, nuk janë të zbuluar ndaj nevojës për shitje me çmim të ulët në kushte të vështira.

Likuidimi dhe falimentimi i një banke nuk mund të krahasohet me këtë situatë, duke qenë se mbështetet në modele biznesi të ndryshme me mekanizma dhe pasoja të ndryshme. Në veçanti, falimentimi i një banke dhe mbyllja e tregjeve të financimit me shumicë që rrjedh nga kjo, mund të shkaktojë me shumë shpejtësi rënien e mbarë sistemit bankar.

### **3. Përkufizimi i riskut të sistemit, nga BSF dhe IAIS**

Shoqata e Gjenevës pajtohet me dobinë e kritereve gjerësisht të përdorura të BSF/FMN-së për identifikimin e burimeve të riskut të mundshëm sistematik: madhësia, ndërlidhja dhe zëvendësueshmëria, të cilat i ka paraqitur BSF dhe përmes të cilave mund të vlerësohet lidhja që kanë me riskun sistematik institucione të veçanta.<sup>7</sup>

IAIS ka propozuar shtimin e “kohës” në këto kritere, për të pasqyruar rolin kritik që luan koha (shpejtësia) në thithjen apo jo nga sistemi financiar të një ngjarjeje të transmetuar në këtë sistem. Shoqata e Gjenevës pajtohet plotësisht me shtimin e këtij kriteri dhe vëren rëndësinë e veçantë që ka për fushën e sigurimeve.

<sup>6</sup> Shih, mes të tjerësh, Shoqatën e Gjenevës, 2010a.

<sup>7</sup> Mirëpo edhe ky përkufizim i BSF-së për riskun e sistemit nuk është se nuk ka hapur debate. Ai ka disa të meta, sikurse shpjegohet në Liedtke (2010).

Tabela 1: Përkufizimi i riskut të sistemit

Përkufizimi i riskut të sistemit

- “Risku i ndërprerjes së fluksit të shërbimeve financiare që (i) shkaktohet nga një dëmtim i të gjithë ose disa pjesëve të sistemit financiar; dhe (ii) ka mundësinë të ketë pasoja të rënda negative për ekonominë reale”
- “Themelor për këtë përkufizim është nocioni se risku sistematik shoqërohet me eksternalitete negative dhe/ose rënie të tregut dhe se rënia ose mosfunksionimi i një institucioni financiar mund të dëmtojë funksionimin e sistemit financiar dhe/ose të ekonomisë reale”

Kriteret për identifikimin e institucioneve me rëndësi për sistemin

- Madhësia: “Vëllimi i shërbimeve financiare të ofruara nga përbërësi i veçantë i sistemit financiar”
- Ndërlidhja: “Lidhjet me përbërësit e tjerë të sistemit”
- Zëvendësueshmëria: “Shkalla me të cilën përbërësit e tjerë të sistemit mund të ofrojnë të njëjtat shërbime në rast të një falimentimi”
- Koha: “Marrja në konsideratë e faktit se risku i sigurimit për sistemin nuk krijon pasoja tronditëse të menjëhershme, por shpërndalet në një periudhë më afatgjatë”

Burimi: BSF, IAIS

Është e rëndësishme të theksohet se efekti që kanë këto kritere të riskut sistematik mund jenë shumë i ndryshme për aktivitete të ndryshme. Kriteret nuk duhet të zbatohen për institucionet

në tërësi por për aktivitetet e veçanta që realizojnë këto institucione, sepse përndryshe ka rrezik që aktivitetet pozitive dhe ato me potencial të vërtetë për risk të sistemit mund të ngatërrohen nën të njëjtin tregues.

**Madhësia:** Me rëndësi kritike është madhësia e aktivitetit me risk të mundshëm sistematik.

**Ndërlidhja:** Me rëndësi kritike është lidhja me sektorin financiar e aktivitetit me risk të mundshëm sistematik.

**Zëvendësueshmëria:** Me rëndësi kritike është zëvendësueshmëria e institucioneve brenda aktivitetit me risk të mundshëm sistematik.

**Koha:** Për tregjet e sigurimeve koha është një kriter shumë i rëndësishëm për shkak të natyrës jo-imediate të thujtjes të gjitha tronditjeve të mundshme ndaj siguruesve.

Zbatimi i kriterëve mbi aktivitete të veçanta dhe jo në mënyrë të përgjithshme mbi institucionet në tërësi ka tre avantazhe kryesore për sistemin financiar dhe për organet rregullatore, si më poshtë:

- përqëndrimi i vazhdueshëm i vëmendjes te aktivitetet ndihmon në vendosjen në shënjestër të burimit të riskut sistematik;
- organet rregullatore do të jenë në gjendje të përdorin burimet e tyre në mënyrë më efektive dhe të efektshme dhe;
- mund të parandalohet trajtimi arbitrar rregullator midis llojeve të ndryshme të institucioneve, duke qenë se merret në konsideratë risku i vërtetë që kanë aktivitetet për sistemin.

*Vijon në numrin tjetër...*

**Për këtë numër punuan:**

E. Shehi, R. Guri, T. Baleta, V. Theodhori, T. Cani, Dh. Hazbiu, E. Kote, G. Hysi, J. Sokoli, R. Eltari, E. Beqir-Aga, E. Kokona

